



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 13.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër të referencës: YQIVTF-0224, për zyrtarin Ibrahim Rudhani, Drejtor për Arsim dhe Shkencë në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin Ibrahim Rudhani, Drejtor për Arsim dhe Shkencë në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (në vijim: SHSKUK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet se (citojmë nga kërkesa): “[...] për rastin e mundshëm të konfliktit të interesit të Prof.Dr. Ibrahim Rrudhani. [...] Prof.Dr. Ibrahim Rrudhani është emëruar Drejtor për Arsim dhe Shkencë të Shskuk-së dhe njëherit mban emërimin e Shefit të Repartit në Klinikën e Nefrologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. [...]”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ dhe në kuadër të saj, ka ndërmarrë veprime verifikuese lidhur me pretendimet e raportuesit të rastit për zyrtarin Ibrahim Rudhani, duke kërkuar dhe administruar informacion zyrtar nga SHSKUK lidhur me ushtrimin eventual të funksioneve apo pozitive publike të zyrtarit në fjalë.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare DPKI-124/26, e ka njoftuar palën për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të shkresës njoftuese zyrtari Ibrahim Rudhani, përmes emailit ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit një sqarim, me përmbajtjen si në vijim: [...] ju njoftoj se unë mbaj pozitën e drejtorit për arsim dhe shkencë në nivel të SHSKUK pozitë funksionale e jo menagjeriale nga se nuk zgjidhem me konkurs por fakulteti i mjekësisë propozon sipas statutit për bashkëpunim me të mirë në mes dy institucioneve mes FM dhe SHSKUK e kurse bordi i SHSKUK emëron drejtorin por pozita është funksionale nga kjo rrjedh se unë nuk menaxhojë punëtor e as të mira materiale. Në vitin afërsisht 2021 kur jam zgjedhur për herë të parë në këtë pozitë, e kam pyetur sekretarin e bordit të SHSKUK se a kam obligim me plotësua formularin e deklarimit të pasurisë dhe ai me ka thënë se kam pyetur në zyrën e APK dhe ka marr me shkrim se sekretari dhe drejtori për arsim dhe shkencë nuk e kanë obligim të deklarojnë pasurinë sipas ligjit në fuqi ngase nuk menaxhoje me punëtor dhe të mira materiale deri në fillimin e deklarimit të rregullte të pasurisë dhe konfliktit të interesit për profesor të fakulteteve publike si FM pjesë e cilat fakultet edhe jam. Kame pyetur edhe zyrën ligjore në QKUK me kanë thënë se pozita e juaj është pozitë funksionale të dhëna ose sqarime që munde të merren nga sekretari i bordit të SHSKUK-se. Duke qenë se jomë profesor i rregullte në FM dhe sipas statutit për themelimin e klinikës duhet të ketë profesor për themelimin e eventualisht ekzistimin e klinike se përndryshe kthehet në shërbim nga ish drejtori jam emëruar ushtrues detyre i shefit të repartit të nekrologjisë në kuadër të klinikes së Nefrologjisë ashtu e parasheh statuti i QKUK-se dhe nga kjo pozitë nuk kam shtesë funksionale. [...]

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është realizuar një takim me zyrtarin Ibrahim Rudhani, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ku i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar informacion zyrtar nga Sekretari i Bordit Drejtues të SHSKUK-së, lidhur me përgjegjësit, detyrat dhe nivelin drejtues të pozitës së Drejtorit për Arsim dhe Shkencë në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, si dhe sqarime për linjën e raportimit dhe përgjegjësi që i takojnë kësaj pozite.

Nga përgjigjja e pranuar nga Sekretari i Bordit Drejtues të SHSKUK-së rezulton se: 'Në vijim të Kërkesës suaj me Nr. Prot. 164/26, datë 30.01.2026, lidhur me përgjegjësit, detyrat, nivelin drejtues si dhe linjën e raportimit të pozitës së Drejtorit për Arsim dhe Shkencë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar (SHSKUK), ju njoftojmë si në vijim: Pozita e Drejtorit për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK është përcaktuar në Pikën 3 të Nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (Kujdes tretësor shëndetësor), ku parashihet se institucionet e nivelit tretësor duhet të kenë Drejtor për Arsim dhe Shkencë, i cili propozohet nga fakulteti përkatës i shkencave mjekësore. Kjo pozitë buron gjithashtu nga dispozitat përkatëse të Statutit të SHSKUK-së. Statuti i mëparshëm i SHSKUK-së, i miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/148, datë 11.09.2013, of Piken 2.7 të Nenit 12, përcaktonte se Bordi Drejtues emëron Drejtorin për Arsim dhe Shkencë me propozim të fakultetit përkatës së shkencave mjekësore. Ndërkaq, Statuti aktual i SHSKUK-së, i miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 29/180, datë 27.12.2023, në Pikën 6 të Nenit 9, përcakton se Drejtori për Arsim dhe Shkencë caktohet nga radhët e profesorëve të fakultetit përkatës të shkencave mjekësore, se kjo pozitë përfaqëson funksion shtesë të profesorit të caktuar dhe kompensohet në përputhje me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Po ashtu, në Pikën 3 të Nenit 6 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm në Administratën Qendrore të

SHSKUK-së, me Nr. Prot. 1701, datë 15.04.2025, përcaktohet se Drejtori për Arsim dhe Shkencë merr pjesë në Bordin Drejtues të SHSKUK-së dhe emërohet nga ky Bord, në bazë të propozimit të Fakultetit të Mjekësisë Universiteti i Prishtinës. Duke qenë se Pika 5 e Nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi parashikon se organizimi dhe zbatimi i procesit edukativ dhe arsimor në institucionet e nivelit tretësor përcaktohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë, ministria përkatëse e arsimit dhe Universiteti i Prishtinës, dhe i miratuar nga Qeveria, dhe duke marrë parasysh se ky akt nënligjor ende nuk është miratuar, fusha e veprimit e kësaj pozite nuk është e definuar në mënyrë të plotë. Megjithatë, pavarësisht kërkesave të Bordit Drejtues për rregullimin e kësaj çështjeje, deri më tani nuk është ndërmarrë veprim konkret lidhur me këtë. [...]. Si rrjedhojë, aktualisht pozita e Drejtorit për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK ka rol koordinues ndërmjet SHSKUK-së dhe Fakultetit të Mjekësisë Universitetit të Prishtinës, merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues të SHSKUK-së pa të drejtë vote, nuk menaxhon buxhet dhe nuk ushtron kompetenca drejtuese mbi staf’.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pasi ka shqyrtuar, analizuar dhe administruar të gjitha provat relevante që lidhen me vërtetimin e fakteve/pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit, informacionet (me shkrim) dhe sqarimet e dhëna në takim nga zyrtari Ibrahim Rudhani, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi si në dispozitiv të këtij vendimi se, në rastin konkret nuk është konstatuar situatë e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në rastin konkret ka pasur parasysh dispozitën e nenit 13 [Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik], paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilën është përcaktuar se: “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”, por ka konstatuar se dispozita në fjalë nuk vlen dhe nuk zbatohet në rastin konkret për faktin se pozita e Drejtorit për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK ka karakter funksional dhe koordinues, pa kompetenca menaxheriale, vendimmarrëse apo administruese mbi staf dhe mjete financiare, ndërsa pjesëmarrja në Bordin Drejtues të SHSKUK-së realizohet pa të drejtë vote.

Ndërsa, sa i përket konfliktit të interesit, zyrtari në fjalë gjatë ushtrimit të funksioneve publike nga cilado cilësi, kurdo dhe në secilin rast kur paraqitet ndonjë situatë e konfliktit rast pas rasti të interesit, ai duhet të (vet)deklaroj atë dhe të tërhiqet nga ajo vendimmarrje, në përputhje me dispozitën e nenit 17, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: *Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimet të këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të SHSKUK-së
- Palës/ve procedurale
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës (bartësit të lëndës)



YI BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit